



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 115, datë 28.06.2024

**PËR
LICENCIMIN E SUBJEKTIT “EXALCO-AL AGENCY” SH.P.K.,
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME,
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e subjektit “Exalco-Al Agency” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a.**
- 2. Miratimin e z. Nikolin Podja, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të subjektit “Exalco-Al Agency” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI